



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të hënën e ardhshme, më 15 shtator, Mbrojtja e Hashim Thaçit do të fillojë me paraqitjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve. Seanca pritet të jetë kryesisht publike. Seanca do të fillojë në orën 9:00 dhe mund të përcillet në internet në tri gjuhët e Gjykatës, shqip, serbisht dhe anglisht, [përmes transmetimit në faqen e internetit të DHSK-së](#), me 45 minuta vonesë.

Për shkak të interesit të lartë, për ta ndjekur seancën nga galeria për publikun në mjediset e gjykatës në Hagë kërkohet regjistrim paraprak. Regjistrimi paraprak tashmë është mbyllur. Kushdo që ka kërkuar regjistrim paraprak për seancën dhe nuk ka marrë ende përgjigje, duhet të marrë përgjigje sot ose nesër. Për shkak të numrit të lartë të kërkesave dhe vendeve të kufizuara në galerinë për publikun, kërkojmë mirëkuptimin tuaj që nuk mund të konfirmojmë pjesëmarrjen nga galeria për publikun për të gjithë personat që e kanë kërkuar. Përparësi u është dhënë shokëve dhe familjarëve të të akuzuarve si dhe mediave, kryesisht mediave të Kosovës.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 9 shtator 2025, Trupi Gjykses pranoi si prova disa aktekspertiza të dorëzuara nga Mbrojtja e Viktimave dhe një provë materiale të dorëzuar nga Mbrojtja. Gjykatësit nuk pranuan një provë materiale tjetër që u kërkuar të pranohej nga Mbrojtja. Kur u pyet lidhur me këtë provë gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare, dëshmitari nuk ishte në gjendje të jepte asnjë kontekst për të, kështu që Trupi Gjykses e konstatoi jorelevante për dëshminë.

Më 8 shtator 2025, Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për të vendosur disa garanci gjatë pyetjeve të dëshmitarëve të thirrur nga ekipet e tjera të Mbrojtjes. Këto përfshinin kufizimin e objektit të pyetjeve dhe moslejimin e palëve që pyetjet në cilësinë e palës jothirrëse të jenë në lidhje me veprimet dhe sjelljen e një të akuzuari që nuk e ka thirrur atë dëshmitar.

Në vendim, Trupi Gjykses shpjegoi se, kuadri i lejuar dhe kufizimet e pyetjeve nga palët jothirrëse janë të përcaktuara në Rregulloren e Procedurës dhe Provave dhe në Urdhrin e Trupit Gjykses për Zhvillimin e Gjykimit. Palët mund t'u bëjnë pyetje dëshmitarëve lidhur me temat e trajtuara nga pala thirrëse si dhe lidhur me besueshmërinë e dëshmitarit, dhe në përgjithësi janë të autorizuar t'u bëjnë pyetje dëshmitarëve për aspekte që lidhen me argumentet e tyre, me kusht që dëshmitari të jetë në gjendje të japë dëshmi relevante për lëndën.

Trupi Gjykses u shpreh se i kishte parasysh shqetësimet e ngritura nga Mbrojtja e Selimit, por do të ishte e parakohshme dhe hamendësuese në këtë fazë që Trupi Gjykses të vendosë kufizime shtesë, pasi ende nuk





ka informacion se çfarë provash mund të synojë Prokuroria të marrë përmes pyetjeve të saj ose për provat që mund të kërkojë të pranohen përmes dëshmitarëve të Mbrojtjes, si dhe nuk ka informacion për llojet e pyetjeve që do të bëjë Prokuroria. Për rrjedhojë, Trupi Gjykues njoftoi se këto shqetësime do t'i trajtojë vetëm nëse kundërshtohet një pyetje që mendohet si e palejueshme nga pala kundërshtuese, ose në momentin e pyetjes, ose në pajtim me procedurën e përcaktuar në Urdhrin për Zhvillimin e Gjykimit.

Në të njëjtën çështje, më 10 shtator, Trupi Gjykues miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për të shtuar deklaratën e një dëshmitari në listën e provave materiale.

